



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priliceno / Pridato Received / Delivered	23.05.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënime Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHTICK	2976/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.345/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.345/2022 të datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë

me adresë në çeshtjen juridike "kontestim konkursi" kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.345/2022 të datës 08.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Komuna e Podujevës me datë 22.01.2021 ka shpallur konkursin me numër të referencës RN00007792 për vendin e punës "Specialistë të Përgjithshëm të Trashëgimisë Kulturore", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 20.12.2021 nxjerr vendimin me numër 228/21 për mos plotësimin e kushteve për aplikim për ankuesen pasi që bazuar në kriteret e konkursit nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme formale të përvojës së punës.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër 228/21 të datës 20.12.2021 të Menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 22.12.2021 parashtron ankesë në Komunën e Podujevës/Njësia e Burimeve Njerëzore.

Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 24.12.2021 merr vendimin me numër 265/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e datës 22.12.2021 e parashtruar nga ankuesja



ankuesja e pa kënaqur me këtë vendim me datë 08.04.2022 nëpërmjet e-mail-it zyrtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, parashtron ankesën me numër të protokollit 1963/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.04.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Podujevës. Këshilli më datë 29.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/31.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 08.04.2022 eparashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 06.04.2022 i Agjencionit për Ndihmë Juridike Falas; Diploma e ankueses; Vërtetimi i papunësisë; Deklarta për bashkësin familjare; Kopja e letër njoftimit; Vendimi i datës 24.12.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Ankesa e ankueses e datës 22.12.2021 e parashtruar në Komunën e Podujevës/Njesisë së Burimeve Njerëzore; Konkursi i datës 22.11.2021; Lista e aplikantëve; Vendimi i datës 11.02.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Akt emërimi i Akt emërimi i Akt emërimi i Akt emërimi i Akt emërimi i Ejup Babatinca; Kontrta e Njoftimi i datës 24.12.2021; Vendimi i datës 20.12.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 20.12.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore; E-mail i datës 28.12.2021 si dhe detajt e aktivitetit për ankuesen si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësimit me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës ka konstatuar së janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankueses **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Komuna e Podujevës, më datë 01.11.2021 ka shpallur Konkursin e hapur me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë, klasa profesional - 2*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.11.2021 deri me 06.12.2021. Në këtë konkurs kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë ndërsa në listën e ngushtë të datës 14.12.2021 janë përfshirë katër (4) kandidatë. Sipas Listës përfundimtare të Komisionit të Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevas, kandidati me i vlerësuar duke u renditur i pari në listë është me gjithsej 80.6 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës, më datë 07.03.2022 ka bërë publikimin e njoftimin për kandidatin e suksesshëm.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesja si kandidatë në Konkursin me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/ Zyrtar i Trashëgimisë*, me datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës kundër Njoftimit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës të datës 07.03.2022, me pretendimet ankimore se gjatë vlerësimit në këtë procedurë të konkurrimit janë bërë shkelje të dispozitave thelbësore ligjore në vlerësimin e datës 07.03.2022, verifikimin paraprak si dhe vlerësimin e jetëshkrimit/CV.

Kolegji, me rastin e shqyrtimit të provave materiale ka konstatuar se edhe kandidati si kandidat në këtë procedurë të rekrutimit, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1910/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku Kolegji i Këshillit me Vendimin A.nr.339/2022 të datës 10.05.2022 ka aprovuar ankesën dhe rrjedhimisht ka anuluar procedurën e rekrutimit me numër reference RN00007792 për pozitën e punës *Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore/Zyrtar i Trashëgimisë*. Andaj, mbi këto arsye, e në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, Kolegji ka konstatuar se janë përmbush kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.345/2022 të datës 08.04.2022, pasi që objekti i ankesës është bërë i pamundur apo i kotë.

Nga sa u tha si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.345/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

